



Prishtinë, 12.10.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1605_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2344_08_22** i dt.15.08.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **05.09.2022**;

në seancën e mbajtur më datë 12.10.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin L. A. (Frutaria SH.P.K.) si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2344_08_22, i datës 15.08.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 15.08.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2344_08_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit L. A., (Frutaria SH.P.K.) dhe e ka obliguar KESCO që të korrigjoj faturat e periudhës 11/2020 deri me datë 01.04.2022, duke e rifaturuar konsumatorin sipas shpenzimit mesatar TL=72% dhe TU=28%.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi i bërë për periudhën kontestuese është i saktë, pasi që është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor.
- Duke u bazuar në raportin e shqyrtimit të dt. 29.06.2022 dhe raportin e verifikimit 26.07.2022 të njehsorit nr.17697772, njehsori ka rezultuar të jetë në rregull dhe brenda kufijve të lejuar të matjes.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2344_08_22 i datës 15.08.2022 për konsumatorin L. A.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj, ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i ZRrE ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës dhe atë si në vijim: Ankesën e konsumatorit të dt. 16.02.2022; Procesverbalin e inspektimit të dt. 10.03.2022; Përgjigjen e KESCO të dt. 07.04.2022; Ankesën e konsumatorit në ZRrE të dt. 28.04.2022; Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e leximit; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 01.04.2022, ka gjetur se gjendja faktike në vendimin e kontestuar është vërtetuar drejtë, dhe rrjedhimisht, ankesa e paditësit është e pabazuar.

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi i ZRrE ka vërejtur se, fillimisht konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO, me kërkesën që t'i bëhet rishqyrtimi i faturave për periudhën 01/2021 e deri në periudhën 02/2022, për shkak të dyshimeve për lexim dhe faturim jo të saktë të njehsorit elektrik. Pas inspektimit të pikës matëse nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij si të pabazuar. Më pas, konsumatori i adresohet ZRrE përmes ankesës, me kërkesën që të bëhet rishqyrtimi i faturave për periudhën e cekur si më lartë, për dy shifrat DPR – 90023740 dhe shifrën DFE – 9035269.

Pasi që është analizuar me kujdes Rrjedha e Energjisë Elektrike si dhe listat e leximit, dhe në veçanti për periudhën kontestuese 01/2021 – 04/2022, është vërejtur se, lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektime dhe lexime të rregullta mujore, por që, nga periudha 10/2020 e deri në periudhën 03/2022, njehsori ka regjistruar shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në tarifën e lartë. Gjithashtu, Bordi ka gjetur se, që nga vendosja e këtij njehsori e deri me datë 09/2020, konsumatori është faturuar me shpenzime të regjistruara në të dy tarifatat, dhe përsëri, nga periudha 10/2020 e deri në ndërrimin e njehsorit ka vazhduar të faturohet në të dy tarifatat.

Pas analizimit të shpenzimeve me njehsorin e ri elektrik nr. 20094344, mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit, e ndarë në përqindje duke u bazuar në shpenzimin total, rezulton të jetë TL=72% dhe TU=28%.

Duke e pasur parasysh strukturën tarifore të aprovuar nga ZRrE si dhe faktin se konsumatori i takon grupit tarifor 4 (7/02 – konsumator jofamiljar – komercial), si dhe duke u bazuar në nenin 54 të Ligjit për Energji Elektrike, në të cilin parashihet si në vijim: *“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”*, Bordi thekson se, KEDS dhe KESCO nuk i kanë ndërmarrë të gjitha masat e parapara, me qëllim të faturimit të konsumatorit me shpenzime reale mujore. Më tej, apeluesi KESCO ka vepruar në kundërshtim me 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, ku përcaktohet si vijon: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifatat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*.

Si përfundim, duke qenë se i licencuari KESCO ka bërë lëshime në faturimin e konsumatorit sipas legjislacionit në fuqi, Bordi e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, vendimin e shkallës së parë, me të cilin është obliguar KESCO që të bëhet korigjimi i faturave për periudhën 10/2020 e deri në periudhën



04/2020 (e ndërrimit të njehsorit), ashtu që, të bëhet shpërndarja e kilovatëve të faturuara në një tarifë të vetme dhe të faturohet konsumatorit sipas shpenzimeve të tanishme me njehsorin e ri, me TL=72% dhe TU=28%.

Ndërkaq lidhur me kërkesën e konsumatorit për shifrën DFE – 9035269, Bordi thekson se ka kërkuar informacione shtesë nga KESCO lidhur me këtë ankesë dhe të njëjtin janë përgjigjur se lënda e konsumatorit është në proces të shqyrtimit. Rrjedhimisht, pasi që konsumatori nuk ka pranuar përgjigje/vendim nga KESCO, kjo pikë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi dhe trajtimi në këtë fazë nga ZRrE.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit L. A., (Frutaria Sh.P.K.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.